



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE
RAJONALE

**ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO – EKONOMIK RAJONAL TË
BALANCUAR NË VITIN 2018**

Qershor, 2019

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe i njëjti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni dhe komunave të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme për përkrahje të sektorit privat në Kosovë.

DOKUMENTI U PUNA NGA:

Blerim Hasani, Drejtor I Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale
Vjendita Avdiu Musliu, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik
Jeton Mehmeti, Konsulent nga UNDP në MZHR

Copyright. 2019 – Ministria e Zhvillimit Rajonal
Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë
Tel. +381 (0) 38 64 516 / <https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave.....	4
Hyrje	5
RAJONI SOCIO EKONOMIK QENDËR	8
RAJONI SOCIO EKONOMIK JUG	11
RAJONI SOCIO EKONOMIK PERËNDIM	15
RAJONI SOCIO EKONOMIK VERI	18
RAJONI SOCIO E KONOMIK LINDJE	22
PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE	26
Burimet e informacionit.....	32
Përfundime	33

Lista e shkurtesave:

MZHR- Ministria e Zhvillimit Rajonal

PZHRB (2018) – Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (2018)

PZHR (2018) - Programi për Zhvillim Rajonal (2018)

AZHR- Agjensioni për Zhvillim Rajonal

RSEK- Rajonet Socio-Ekonomike të Kosovës

RSEJ- Rajoni Socio- Ekonomik Jug

RSEV- Rajoni Socio-Ekonomik Veri

RSEL- Rajoni Socio Ekonomik Lindje

RSEQ-Rajoni Socio-Ekonomik Qendër

RSEP- Rajoni Socio-Ekonomik Perëndim

HYRJE

Ministria e Zhvillimi Rajonal (MZHR), bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, zhvillon dhe menaxhon projekte për të ofruar zhvillim socio – ekonomik rajonal të balancuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bënë promovimin e tyre. Përmes Programit vjetor për Zhvillim Rajonal të Balancuar, MZHR stimulon zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar ndërmjet pesë (5) rajoneve zhvillimore: rajonin Qendër, rajonin Veri, rajonin Perëndim, rajonin Lindje dhe rajonin Jug. Edhe në vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim, përmes realizimit të programeve MZHR synon të kontribuoj në funksion të rritjes ekonomike, reduktimit të pabarazive socio-ekonomike rajonale, stimulimit të punësimit dhe rritjes së mirëqenies së popullësisë në përgjithësi.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka zhvilluar dhe implementuar për herë të parë dy (2) programe për zhvillim rajonal në tërë territorin e Kosovës: PZHR-“Programin për zhvillim rajonal” i cili ka përfshirë financimin e projekteve kapitale në gjitha Komunitetet e Kosovës dhe PZHRB - “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar”, i cili është realizuar përmes Grant Skemës për mbështetje financiare të bizneseve me projekte në tërë territorin e Kosovës. Kjo Grant Skemë është publikuar nga MZHR me datë 21.05.2019. Për sqarimin e procesit të aplikimit dhe ofrimit të udhëzimeve ndaj aplikantëve, MZHR ka mbajtur pesë (5) sesione informuese në pesë (5) rajonet socio – ekonomike.

PZHRB (2018) ka pas për qëllim plotësimin e nevojave të bërit biznes në pesë (5) rajonet zhvillimore të Kosovës (Qendër, Perëndim, Lindje, Veri dhe Jug). Shuma e financimit të këtij programi në vitin 2018, ka qenë 1.4 milion euro. Synim i këtij programi të lansuar nga MZHR ka qenë përkrahja e bizneseve të reja me potencial rritje, gjenerimi i vendeve të reja të punës me theks të veçantë tek të rinjtë, si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksportit të produkteve vendore. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar-PZHRB (2018), janë pranuar në nivel të Kosovës 1696 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3).Në kategorinë Lot1 ,MZHR ka pranuar 733 aplikacione në total, në kategorinë Lot 2 janë pranuar 233 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 730 aplikacione në total .Realizimi i pranimin të aplikacioneve në pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore është realizuar përmes mbështetjes dhe bashkëpunimit profesional të pesë (5) Agjensioneve për Zhvillim Rajonal: (AZHR Qendër, AZHR Veri, AZHR Jug, AZHR Lindje dhe AZHR Perëndim) . MZHR gjatë vitit 2018 në kuadër të PZHRB 2018 ka financuar dhe monitoruar 145 projekte në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës. Përfitues të financimit nga MZHR, kanë qenë biznese nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës, të dy gjinive (femrore dhe mashkullore), si dhe nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Realizimi i këtij programi, ka pas efekt në gjenerimin e 561 vendeve të reja të punës, hapjen e një numri të madh të bizneseve të reja të vet-punësimit, si dhe rritjen në masë të konsiderueshme të kapaciteteve prodhuese të bizneseve ekzistuese.

Marrë parasysh se MZHR është ministri e re dhe ende në fazë të konsolidimit, kjo analizë trajton vetëm programin e MZHR-së për zhvillim socio – ekonomik rajonal të balancuar të realizuar në vitin 2018. Ky dokument, do të shërbejë vetëm si pikënisje për vitet e

ardhshme, ku do të bëhet një analizë më gjithëpërfshirëse duke trajtuar edhe programet e ministrive të linjës për përkrahje të bizneseve dhe sektorit privat në përgjithësi.

Implementimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 – Skema e Granteve për Biznese

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018, është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së granteve për biznese, e shpërndarë në lote.

Përkufizimi i lotëve dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon:

- LOT1- Përfshinë të gjitha projektet – bizneset Start-UP në vlerë 1.000€ deri 5.000€
- LOT2- Përfshinë gjitha projektet- bizneset të cilat kanë përvojë biznesore deri dy (2)vite në vlerë prej 5.000€ deri 10.000€
- LOT3- Përfshinë gjitha projektet bizneset e konsoliduara të cilat kanë përvojë më shumë se dy (2) vite prej 10.000€ në vlerë deri 20.000€

Skema e granteve bazuar në “Programin Zhvillimor Rajonal të balancuar” gjatë vitit 2018 ka mbështetur në total 145 projekte të cilat janë shpërndarë si mëposht:

- Në rajonin socio-ekonomik Qendër (Komuna e Prishtinës me komunitat për rreth), tridhjetë projekte (30);
- Në rajonin socio-ekonomik Lindje (Komuna e Gjilanit me komunitat për rreth), njëzetë e nëntë (29) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik Perëndim (Komuna e Pejës me komunitat për rreth), tridhjetë e një (31) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik Veri (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunitat për rreth), njëzet e katër projekte (24);
- Në rajonin socio-ekonomik Jug (Komuna e Prizrenit me komunitat për rreth, tridhjetë e një (31) projekte

Numri i përgjithshëm i personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës është 561 të punësuar ku nga ata në: rajonin Qendër janë punësuar 177 persona, në rajonin Lindje 101 persona , në rajonin Perëndim 100 persona , në rajonin Veri 87 persona dhe në rajonin Jug 96 persona.

Llojet e veprimtarive të projekteve të mbështetura nga Grant Skema për Zhvillim Rajonal të Balancuar (2018), kanë përfshirë më së shumti veprimtaritë prodhuese dhe të përpunimit si dhe shërbimeve nga më të ndryshmet si: konsulencë, teknologji informative, inxhinieri, shërbime automekanike/ autoservisim , shërbime të mjekësisë, floktarisë, rrobaqepësisë, dizajn, shërbime të pastrimit etj. Veprimtaritë prodhuese kanë qenë më së shumti të orientuara në: prodhimet e miellit, përpunimit të mishit, prodhime të materialeve të tekstilit dhe plastikës, prodhimin dhe përpunimin e hekurit, drurit, prodhimin dhe përpunimin e çajreve, frutave, produkteve malore, ëmbëlsirave etj.

Në tabelat e mëposhtme do të mund të shihni në formë më të detajuar të gjitha projektet e financuara për vitin 2018 nga MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal në (5) pesë rajonet socio-ekonomike në Kosovë, të ndara në Lot1, Lot2 dhe Lot 3 , të cilat do të pasqyrojnë në mënyrë më të qartë shpërndarjen e balancuar të projekteve dhe financimeve nëpër Komuna si dhe ndikimit që ka pas programi zhvillimor në zhvillimin rajonal të balancuar në tërë territorin e Kosovës i cili program ka investuar shumen totale prej 1.346.806,00€ në (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore.

**RAJONI SOCIO EKONOMIK QENDËR
(RSEQ)**

Projektet e realizuara nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I zhvillimit rajonal të balancuar”, (Viti 2018)

Në rajonin socio-ekonomik Qendër I cili përfshin tetë (8) Komuna: (Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtime, Podujevë Obiliq dhe Lipjan) në total janë mbështetur 30 projekte duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha Komunat përbërëse të këtij rajoni. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar-PZHRB (2018) në rajonin socio ekonomik Qendër janë pranuar nga AZHR Qendër 450 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga tetë (8) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 450 , në kategorinë Lot 1 janë pranuar 219 aplikacione ,në kategorinë Lot 2 janë pranuar 56 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 175 aplikacione.

Në kategorinë Lot 1 e cila kategori ka përfshirë financimin në vlerë deri 5000€ për bizneset e reja apo të ashtuquajtura “Start Up” është realizuar mbështetja financiare në vleren totale prej 60.663, 75€. Në rajonin socio-ekonomik Qendër janë financuar 14 projekte në total në kategorinë e LOT 1 dhe janë punësuar 28 persona. Veprimtaritë më të shpeshta të financuara kanë qenë: shërbimet e ndryshme si ato të tekstilit, shtypit në 3D, veprimtaritë e prodhimit të çantave, askesorëve nga lëkura, prodhime nga përpunimi I drurit, xhamit, plastikës dhe shërbime të gastronomisë. Projektet e financuara kanë plotësuar gjitha kriteret administrative dhe përmbajtësore të rregulluara sipas udhëzuesit përkatës së MZHR-së për PZHRB 2018.

Në kategorinë Lot 2 kanë gjet mbështetje financiare të gjitha bizneset të cilët kanë pas përvojë deri në 2 vite në veprimtarinë e tyre biznesore. Vlera totale e investuar nga Grant Skema e MZHR-së (2018) në kategorinë e LOT2 në Rajonin Qendër ka qenë 71,670.00€, ku janë mbështet 8 biznese dhe janë punësuar 89 persona. Vlera e projekteve e financuar në Lot 2 ka variu deri nga 5.000€ në vleren 10.000€, ku të gjitha projektet kanë plotësuar kriteret e percaktuara me udhëzuesin për aplikim në Skemen e Granteve për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Llojet e veprimtarive më të shpeshta në Lot 2 kanë qenë: sektori I tekstilit, dizajnimi, modelimet arkitekturore, shërbimet e konsulencës dhe inxhinierisë, shërbimet e konsulencës në sektorin e burimeve njerzore, shërbime të stomatologjisë dhe rrobaqepësisë.

Bizneset të cilat kanë pasë për bazë veprimtaritë prodhuese me kapacitete më të mëdha të fuqisë punëtore dhe bizenset të cilat veprimtaria e tyre biznesore ka qenë e regjistruar mbi dy vite kanë gjetë mbështetje financiare në kategorinë Lot 3 ku vlera totale e investuar në LOT 3 ka qenë 144.878, 00€ ku janë punësuar 60 persona brenda 8 projekteve . Vlera e projekteve të financuara në Lot 3 ka variuar brenda vlerës deri 20.000€. Bizneset me veprimtaritë më të shpeshta në Lot 3 kanë qenë bizneset me veprimtari të prodhimit të ushqimit, prodhimit dhe përpunimit të produkteve nga plastika, llamarina, prodhimit të produkteve konditorike dhe shërbimeve të mirëmbajtjes dhe pastrimit të objekteve private dhe publike.

Duke u bazuar në analizën paraprake të DPASER, veprimtaritë biznesore në rajonin socio ekonomik Qendër të mbështetura nga Grant Skema e lansuar nga MZHR për vitin 2018 kanë arrit mbështetjen financiare në shumën totale prej 277.211, 75€ . Kjo mbështetje financiare nga MZHR ka arrit të punësoj 117 të papunësuar dhe është rajoni me numrin më të madh të të punësuarve nga Programi për zhvillim Rajonal të Balancuar në këtë rajon dhe ky punësim nga ana e bizneseve përfituese është dëshmuar me kontributet pensionale të punëtorve të regjistruar në ATK. MZHR në Rajonin Socio Ekonomik Qender ka mbështet financiarisht në total 30 bizense.

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT 1)					
LOT 1	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punësuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prishtinë	Shërbime profesionale	2	1	4820
	Prishtinë	Shërbime me 3D printer	2	1	4299.75
	Prishtinë	Përpunimi i këpucëve dhe lëkurës	2	1	5000
	Prishtinë	Naërrmarje shrbyses	3	1	4700
	Drenas	Produkte dhe shrbime tekstili	2	1	4954
	Prishtinë	Prodhim i çantave dhe aksesorëve nga lëkura dhe tekstili	2	1	3940
	Obiliq	Prodhim i produkteve nga plastika	2	1	5000
	Podujevë	Prodhim i ëmbëlsirave	2	1	4480
	Fushë Kosovë	Ofrim i shërbimeve për pastrim kimik	2	1	5000
	Prishtinë	Tekstil	4	1	4000
	Graçanicë	Prodhime nga druri	1	1	3950
	Graçanicë	Paketime nga letra dhe plastika për shërbime te prodhuesve organik	2	1	4500
	Graçanicë	Shërbime të produkteve nga xhami	1	1	2890
	Graçanicë	Shërbime të gastronomisë	1	1	3130
Gjithësej: (LOT 1)			28	14	60.663,75€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT 2)					
LOT 2	Komuna përfituese	Përshkrimi I projektit	Numri I të punsuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prishtinë	Dizajn -Modë	5	1	9627
	Podujevë	Tekstil	4	1	9990
	Prishtinë	Arkitekturë-modelim	2	1	7553
	Prishtinë	Shërbime të inzhinjerisë dhe konsulencë	2	1	10000
	Podujevë	Prodhimtari dhe përpunim I drurit	4	1	9000
	Obiliq	Rrobaqepësi	3	1	9000
	Prishtinë	Konsulencë dhe burime njerësore	67	1	9500
	Graçanicë	Stomatologji	2	1	7000
Gjithësej: (LOT 2)			89	8	71,670.00 €

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT 3)					
LOT 3	Komuna përfituese	Përshkrimi I projektit	Numri I të punsuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prishtinë	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve provate dhe publike	21	1	18.832,00
	Prishtinë	Prodhim I ushqimit (akullore dhe çokolladë)	3	1	19.500,00
	Prishtinë	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve private dhe publike	15	1	15.696,00
	Fushë Kosovë	Shtypja e logove	3	1	13.300,00
	Graçanicë	Prodhim	5	1	20.000,00
	Lipjan	Shërbime të internetit dhe televizionit kabllor	4	1	20.000,00
	Graçanicë	Prodhimi I produkteve të vogla konditorike	5	1	17.550,00
	Podujevë	Prodhimi dhe përpunimi I llamarines	4	1	20.000,00

Gjithësej: (LOT 3)	60	8	144.878,00€
---------------------	----	---	-------------

Tabela e përgjithëshme e investimeve për rajonin socio-ekonomik Qendër (Lot1, Lot2, Lot3):

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR	Lot1, Lot2, Lot3	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	LOT 1	28	14	60.663,75€
	LOT 2	89	8	71.670,00€
	LOT 3	60	8	144.878,00€
	Gjithësej :	177	30	277.211,75€

**RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG
(RSEJ)**

Projektet e realizuara nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I zhvillimit rajonal të balancuar", (Viti 2018)

Në rajonin socio-ekonomik Jug, i cili përfshin gjashtë (6) Komuna: (Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë, Dragash dhe Mamushë) në total janë mbështetur 31 projekte duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në të gjitha Komunat përbërëse të këtij rajoni. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar- PZHRB (2018) në rajonin socio ekonomik Jug janë pranuar nga AZHR Jug 403 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 403 , në kategorinë Lot 1 janë pranuar 154 aplikacione ,në kategorinë Lot 2 janë pranuar 49 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 200 aplikacione.

Në kategorinë Lot 1 e cila kategori ka përfshirë financimin nga 1.000€ deri në vlerë 5000€ ndaj bizneseve të reja apo te ashtuquajtura "Start Up" është realizuar mbështetja financiare në vleren totale prej 69.609, 20€. Në rajonin socio-ekonomik Jug janë financuar 15 projekte në total në kategorinë e LOT 1 dhe janë punësuar 24 persona. Veprimtaritë më të spitaktura mjaft të ngjajshme edhe me rajonet tjera kanë qenë: shërbimet e ndryshme si ato projektuese, veprimtaritë e prodhimit dhe përpunimit të produkteve malore ,prodhimi i çantave, askesorëve nga lëkura, prodhime nga përpunimi i drurit, shërbime të gastronomisë, floktarisë, rrobaqepësisë, industrinë ushqimore ,shërbime të paketimit, përpunimit të mishit dhe produkteve nga mishi,prodhimi i akulloreve etj. Projektet e financuara kanë plotësuar gjitha kriteret administrative dhe përmbajtësore të rregulluara sipas udhëzuesit përkatës së MZHR-së.

Në kategorinë Lot 2 kanë gjet mbeshtetje financiare gjitha bizneset të cilet kanë pas përvojë deri në 2 vite në veprimtarinë e tyre biznese. Vlera totale e investuar nga Grant Skema e MZHR-së (2018) në kategorinë e LOT2 në Rajonin Jug ka qenë 76,890.00€ ku janë mbështet 8 biznese dhe janë punësuar 40 persona. Vlera e projekteve e financuar në Lot 2 ka variu deri në vleren 10.000€ ku gjitha projektet kanë plotësuar kriteret e percaktuara me udhëzuesin për aplikim në Skemen e Granteve për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Llojet e veprimtarive më të shpeshta në

Lot 2 kanë qenë në sektorët e prodhimit si ata të: metaleve, produkteve malore, këpucëve, në industrinë e tekstilit, shërbimet gjeodezike -fotogrametrike, shëndetësi, analiza laboratorike si dhe në përpunim dhe paketim.

Bizneset të cilat kanë pasë për bazë veprimtaritë prodhuese me kapacitete më të mëdha të fuqisë punëtore dhe bizneset të cilat veprimtaria e tyre biznese ka qenë e regjistruar mbi dy vite kanë gjetë mbështetje financiare në kategorinë Lot 3 ku vlera totale e investuar në LOT 3 ka qenë 157.850, 00€ ku janë punësuar 32 persona brenda 8 projekteve . Vlera e projekteve të financuara në Lot 3 ka variu brenda vlerës deri 20.000€. Bizneset me veprimtaritë më të shpeshta në Lot 3 kanë qenë bizneset me veprimtari të prodhimit dhe përpunimit të metaleve dhe granitit, sistemeve te ventilimit, prodhimit të softuerëve, prodhimit të ambalazhit, prodhimit të PVC-së dhe prodhimit dhe përpunimit të drurit.Ky Lot me projektet e financuar edhe veprimtaritë e tyre prodhuese ka synuar të zëvendësoje importin si qëllim kryesor I kësaj skeme të Granteve të lansuar nga MZHR.

Veprimtaritë biznese në rajonin socio ekonomik Jug të mbështetura nga Grant Skema e lansuar nga MZHR per vitin 2018 kanë arrit mbështetje financiare në shumën totale prej 304.349, 20€. Kjo mbështetje financiare nga MZHR ka arrit të punësoj 96 të papunësuar në këtë rajonin dhe ky punësim nga ana e bizneseve përfituese është dëshmuar gjithashtu me kontributet pensionale të punëtorve të regjistruar ne ATK. MZHR në rajonin socio ekonomik Jug ka mbështet financiarisht 31 biznese në total.

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG					
(LOT 1)					
LOT 1	Komuna përfitues e	Përshkrimi I projektit	Numri I të punsuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prizren	Shërbime projektuese	2	1	4000
	Selo Planjane	Prodhim, përpunim dhe shitje	1	1	5000
	Prizren	Industria udhqimore	2	1	5000
	Prizren	Sallon I parukerisë, frizer e	1	1	4500
	Prizren	Rrobaqepësi	1	1	3500
	Prizren	Instalim I sistemit të ngrohjes qendrore	2	1	4400
	Prizren	Industria e ushqimit (përpunim dhe prodhim I iembelsirave)	1	1	4800
	Prizren	Prodhimi I çantave ,kuletave,	2	1	4880

		jastekeve dekorues			
	Mamushë	Paketim I sheqerit në pako stick	2	1	5000
	Suharekë	Rrobaqepësi	3	1	4700
	Rahovec	Përpunim I mishit dhe produkteve të mishit	1	1	4329.20
	Dragash	Prodhim I akulloreve	1	1	5000
	Prizren	Prodhim I këpucëve	3	1	5000
	Prizren	Sallon bukurije	2	1	4700
Gjithësej (Lot 1)			24	15	69.609,20€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG					
(LOT 2)					
LOT 2	Komuna përfitues e	Përshkrimi I projektit	Numri I të punsuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prizren	Prodhim I këpucëve	10	1	9690
	Suharekë	Shëndetësi, analiza laboratorike	1	1	9800
	Prizren	Prodhim I produkteve malore	4	1	9900
	Prizren	Industria e tekstit, prodhimi I tharësve (air-bag-ve nga polietileni)	7	1	10,000.00
	Prizren	Prodhim dhe përpunim I metaleve	4	1	10,000,00
	Prizren	Përpunim dhe paketim (asete të prekshme)	5	1	9000
	Rahovec	Shërbime gjeodezike	2	1	8500
	Prizren	Prodhim I produkteve malore	7	1	10,000,00
Gjithësej: (Lot 2)			40	8	76.890,00€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG					
(LOT 3)					
LOT 3	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Prizren	Prodhimi i sistemeve të ventillimit	2	1	20.000,00
	Prizren	Prodhimi i softuerëve	3	1	20.000,00
	Rahovec	Prodhimi i ambalazhit	4	1	20.000,00
	Prizren	Përpunimi i granitit	3	1	20.000,00
	Prizren	Përpunim i metaleve	5	1	20.000,00
	Prizren	Prodhim i PVC-ve	5	1	20.000,00
	Suharekë	Prodhim dhe përpunim i drurit	5	1	19.850,00
	Prizren	Teknologji informative, shpërndarje e internetit	5	1	18.000,00
Gjithësej : (Lot 3)			32	8	157.850,00 €

Tabela e përgjithëshme e investimeve për rajonin socio-ekonomik Jug (Lot1, Lot2, Lot3):

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG	Lot1, Lot2, Lot3	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	LOT 1	24	15	69.609,20€
	LOT 2	40	8	76.890,00€
	LOT 3	32	8	157.850,00€
	Gjithësej :	96	31	304.349,20€

**RAJONI SOCIO EKONOMIK PERËNDIM
(RSEP)**

Projektet e realizuara nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I zhvillimit rajonal të balancuar", (Viti 2018)

Në rajonin socio-ekonomik Perëndim I cili përfshin gjashtë (6) Komuna: (Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë) në total janë mbështetur 31 projekte duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha Komunat përbërëse të këtij rajoni. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar- PZHRB (2018) në rajonin socio ekonomik Perëndim janë pranuar nga AZHR Perëndim 257 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 257 , në kategorinë Lot 1 janë pranuar 104 aplikacione ,në kategorinë Lot 2 janë pranuar 35 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 118 aplikacione.

Sikurse edhe në rajonet e lart përmendura kategoria Lot 1 ka përfshirë financimin nga 1.000€ deri në vlerë 5000€ ndaj bizneseve të reja apo te ashtuquajtura "Start Up" ku është realizuar mbështetja financiare në vleren totale prej 60.811, 50€. Në rajonin socio-ekonomik Perëndim janë financuar 14 projekte në total në kategorinë e LOT 1 dhe janë punësuar 37 persona .Veprimtaritë më të spitaktura kanë qenë veprimtaritë e përpunimit dhe prodhimit të dredhzës dhe reçelit,makaronave, produkteve në argjilë të pjekur,prodhimin e çantave, përpunimin e tekstilit, drurit, video produksion, art dhe krijimtari, rrobaqepësi, floktari etj. Projektet e financuara kane plotësuar gjitha kriteret administrative dhe përmbajtësore të rregulluara sipas udhëzuesit përkatës së MZHR-së.

Në kategorinë Lot 2 kanë gjet mbeshtetje financiare gjitha bizneset të cilat kanë pas përvojë deri në 2 vite në veprimtarinë e tyre biznesore. Vlera totale e investuar nga Grant Skema e MZHR-së në kategorinë e LOT2 në Rajonin Perëndim ka qenë 66.852,00 €, ku janë mbështet 8 biznese dhe janë punësuar 20 persona. Vlera e projekteve e financuar në Lot 2 ka variuar deri në vleren 10.000€ ku gjitha projektet kanë plotësuar kriteret e percaktuara me udhëzusun për aplikim në Skemen e Granteve për zhvillim rajonal të balancuar. Llojet e veprimtarive më te shquara në Lot 2 dhe atipike për rajonin dhe zhvillimin e ekonomik kanë qenë veprimtaritë prodhuese dhe përpunimit të produkteve, paketimin e sheqerit, prodhimin e mobiljeve dhe artikujve shtëpiak, auto mirëmbajtje dhe ngjyrosje, prodhim I koshereve për bletë, veprimtari shërbyese komerciale dhe përpunimin e metaleve.

Bizneset të cilat kanë pasë për bazë veprimtaritë prodhuese me kapacitete më të mëdha të fuqisë punëtore dhe bizenset të cilat veprimtaria e tyre biznesore ka qenë e regjistruar mbi dy vite kanë gjetë mbështetje financiare në kategorinë Lot 3 ku vlera totale e investuar në LOT 3 ka qenë 175.500, 00€ ku janë punësuar 43 persona brenda 9 projekteve . Vlera e projekteve të financuara në Lot 3 ka variu brenda vlerës deri 20.000€. Bizneset me veprimtaritë më të shquara në Lot 3 kanë qenë bizneset me

veprimtari të prodhimit dhe përpunimit të drurit, prodhimin e mobiljeve, prodhimin e birres natyrale, prodhimin e bukës dhe ëmbëlsirave, prodhimin e dyerve dhe dritareve nga plastika, dizajnim dhe rrobaqepësi.

Duke u bazuar në analizën paraprake të DPASER, veprimtaritë biznesore në rajonin socio ekonomik Perëndim të mbështetura nga Grant Skema e lansuar nga MZHR për vitin 2018 kanë arrit mbështetje financiare në shumën totale prej 303.163, 50 €. Kjo mbështetje financiare nga MZHR ka arrit të punësoj 100 të papunësuar dhe gjithashtu ky punësim nga ana e bizneseve përfituese është dëshmuar me kontributet pensionale të punëtorve të regjistruar në ATK. MZHR në rajonin socio ekonomik Perëndim ka mbështet financiarisht 31 bizense në total.

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM					
(LOT 1)					
LOT 1	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Pejë	Shërbime-Sallon bukurie	2	1	4640
	Gjakovë	Prodhim i makaronave	7	1	5000
	Gjakovë	Dizajn rrobaqepësie	2	1	5000
	Gjakovë	Prodhim i produkteve në argjilë të pjekur	2	1	3391.50
	Pejë	Shërbime makineri	2	1	3000
	Pejë	Prodhim i çantave	4	1	5000
	Gjakovë	Përpunim i tekstilit	4	1	5000
	Deçan	Rrobaqepësi	2	1	3700
	Pejë	Përpunim i drurit	2	1	5000
	Gjakovë	Video produksion	2	1	4500
	Deçan	Krijimtari/Art	1	1	2000
	Deçan	Rrobaqepësi	1	1	4700
	Pejë	Rrobaqepësi	3	1	4880
	Pejë	Përpunim	3	1	5000
Gjithësej (Lot 1)			37	14	60.811,50€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM					
(LOT 2)					
LOT 2	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Deçan	Prodhim , përpunim i produkteve (makinave)	4	1	9900
	Klinë	Paketim i sheqerit për pije të ngrohta	2	1	9900
	Pejë	Prodhim i mobileve dhe artikujve shtëpiak dhe mobileve për dyqane/zyra	2	1	10.000,00
	Gjakovë	Auto ngjyrosje	4	1	7650
	Gjakovë	Auto mirëmbajtje	3	1	6622
	Pejë	Prodhim i koshereve për bletë	1	1	10.000
	Istog	Veprimtari shërbyese komerciale	2	1	4730
	Istog	Përpunimi i metaleve	2	1	8050
Gjithësej (Lot 2)			20	8	66.852,00€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM					
(LOT 3)					
LOT 3	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Deçan	Prodhim dhe përpunim i drurit	9	1	20.000,00
	Pejë	Prodhimi i mobiljeve	9	1	10.000,00
	Istog	Prodhimi i mobiljeve të drurit	3	1	20.000,00
	Klinë	Prodhim	5	1	17.500,00
	Pejë	Dizajn të modes dhe rrobaqepësi	3	1	20.000,00

	Klinë	Prodhim I bukës, sismiteve dhe ëmbëlsirave	3	1	20.000,00
	Gjakovë	Prodhim I dyerve dhe dritareve nga plastika	3	1	20.000,00
	Gjakovë	Prodhim I drurit	2	1	20.000,00
	Pejë	Prodhim I dyerve dhe dritareve të plastikes	6	1	20.000,00
Gjithësej : (Lot 3)			43	9	175.500,00€

Tabela e përgjithëshme e investimeve për rajonin socio-ekonomik Perëndim (Lot1, Lot2, Lot3):

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM	Lot1, Lot2, Lot3	Numri I të punsuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	LOT 1	37	14	60.811,50€
	LOT 2	20	8	66.852,00€
	LOT 3	43	9	175.500,00€
	Gjithësej :	100	31	303.163,50€

**RAJONI SOCIO – EKONOMIK VERI
(RSEV)**

Projektet e realizuara nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I zhvillimit rajonal të balancuar”, (Viti 2018)

Në rajonin socio-ekonomik Veri I cili përshin shtatë (7) Komuna: (Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtri dhe Skenderaj) në total janë mbështetur 24 projekte duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha Komunat përbërëse të këtij rajoni. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar-PZHRB (2018) në rajonin socio ekonomik Veri janë pranuar nga AZHR Veri 194 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga tetë (8) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 194 , në kategorinë Lot 1 janë pranuar 102 aplikacione ,në kategorinë Lot 2 janë pranuar 29 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 63 aplikacione.

Në kategorinë Lot 1 e cila kategori ka përfshirë financimin nga 1.000€ deri në vlerë 5000€ ndaj bizneseve të reja apo te ashtuquajtura “Start Up” është realizuar

mbështetja financiare në vleren totale prej 59.087, 50€. Në rajonin socio-ekonomik Veri janë financuar 14 projekte në total në kategorinë e LOT 1 dhe janë punësuar 37 persona .Veprimtaritë më të spikatura kanë qenë: shërbimet e ndryshme si ato të marketingut dhe zhvillimit të ëeb-faqeve, shërbimet e fotokopjimit dhe skanimin, të shërbimeve auto-diagnostifikuese, floktarisë ,rrobaqepësisë ,teknologjisë së informacionit si dhe veprimtaritë e prodhimit të shamponave, produkteve të drurit, përpunimit të pemëve dhe perimeve, produkteve shërbyese komerciale, etj.Projektet e financuara kanë plotësuar gjitha kriteret administrative dhe përmbajtësore të rregulluara sipas udhëzuesit përkatës së MZHR-së.

Vlera totale e investuar nga Grant Skema e MZHR-së në kategorinë e LOT2 në Rajonin Veri ka qenë 32.125,00 €, ku janë mbështet 4 biznese dhe janë punësuar 12 persona. Në kategorinë Lot 2 kanë gjet mbeshtetje financiare gjitha bizneset të cilat kanë pas përvojë deri në 2 vite në veprimtarinë e tyre biznesore. Vlera e projekteve e financuar në Lot 2 ka variu deri në vleren 10.000€ ku gjitha projektet kanë plotësuar kriteret e percaktuara me udhëzuesin për aplikim në Skemen e Granteve për zhvillim rajonal të balancuar. Llojet e veprimtarive më të shquara në Lot 2 kanë qenë: industria e tekstilit, shërbimet e servisimit të paisjeve elektrike, shërbimet shëndetsore dhe prodhimi i materialeve shtëpiake dhe orendive të tjera.

Bizneset të cilat kanë pasë për bazë veprimtaritë prodhuese me kapacitete më të mëdha të fuqisë punëtore dhe bizneset të cilat veprimtaria e tyre biznesore ka qenë e regjistruar mbi dy vite kanë gjetë mbështetje financiare në kategorinë Lot 3 ku vlera totale e investuar në LOT 3 ka qenë 116.900,00€ ku janë punësuar 38 persona brenda 6 projekteve . Vlera e projekteve të financuara në Lot 3 ka variu brenda vlerës deri 20.000€. Bizneset me veprimtaritë më të shquara në Lot 3 kanë qenë bizneset me veprimtari të prodhimit të ushqimit, prodhimit dhe përpunimit të produkteve të ushqimit, prodhimin e roleteve nga montimi deri në shitje,shkrirjen dhe përpunimin e metaleve,prodhimin e materialeve termo – hidro izoluese,riciklimin e vajrave të zeza dhe vajrave mbeturinë dhe shërbimet shëndetësore-fizioterapeutike.

Duke u bazuar në analizën paraprake të DPASER, veprimtaritë biznesore në rajonin socio ekonomik Veri të mbështetura nga Grant Skema e lansuar nga MZHR për vitin 2018 kanë arrit mbështetje financiare në shumën totale prej 208.112, 55 €. Kjo mbështetje financiare nga MZHR ka arrit të punësoj 87 të papunësuar dhe ky punësim nga ana e bizneseve përfituese është dëshmuar gjithashtu me kontributet pensionale të punëtorve të regjistruar ne ATK. MZHR në rajonin socio ekonomik Veri ka mbështet financiarisht 24 biznese në total .

RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI					
(LOT 1)					
LOT 1	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punësuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Vushtrri	Prodhimi i produkteve të tekstilit	2	1	3670
	Vushtrri	Prodhim i shamponave	5	1	4400

Mitrovicë Veriore	Shërbime të marketigut dhe Ëeb-zhvillimit	4	1	4960
Skenderaj	Shërbime fotokopje dhe skanim	3	1	5000
Vushtri	Auto Diagnostifikues	2	1	5200
Mitrovicë	Teknologji informative	2	1	3642.50
Mitrovicë	Sallon bukurie	2	1	3950
Mitrovicë	Sallon bukurie	2	1	3900
Leposaviq	Prodhim I produkteve të drurit	3	1	5000
Vushtri	Rrobaqepësi	2	1	3810
Zubin Potok	Përpunimi I pemëve dhe perimeve	2	1	4990
Leposavic	Investime në të mira materiale	2	1	4805
Leposaviq	Prodhimi dhe përpunimi I produkteve shërbyese	6	1	4470
Leposaviq	Prodhimi I produkteve ushqimore	2	1	4960
Gjithësej (Lot 1)		37	14	59.087,50€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI					
(LOT 2)					
LOT 2	Komuna përfituese	Përshkrimi I projektit	Numri I të punuarve	Numri I bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Mitrovicë Jugore	Servisimi I pasijeve elektrike	3	1	7125
	Leposaviq	Industria e tekstit	3	1	5000
	Mitrovicë Jugore	Shërbime shëndetsore	3	1	10.000,00
	Skenderaj	Prodhim I materialeve shtëpiake	3	1	10.000,00

		dhe orendive të tjera			
Gjithësejt (Lot 2)			12	4	32.125,00€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI (LOT 3)					
LOT 3	Komuna përfituese	Përshkrimi projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Skenderaj	Shërbime shëndetësore-Fizioterapi	3	1	20.000,00
	Mitrovicë	Përpunim i ushqimit	13	1	20.000,00
	Mitrovicë	Prodhim (roletave,profileve te aluminit)	5	1	20.000,00
	Vushtri	Shkrija dhe përpunimi i metaleve	5	1	16.900,00
	Mitrovicë	Prodhimi i metaleve termo-hidro-izoluese	5	1	20.000,00
	Vushtri	Riciklimi i vajrave të zeza dhe vajrave mbeturinë	7	1	20.000,00
Gjithësejt : (Lot 3)			38	6	116.900,00€

Tabela e përgjithëshme e investimeve për rajonin socio-ekonomik Veri (Lot1, Lot2, Lot3):

RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI	Lot1, Lot2, Lot3	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	LOT 1	37	14	59.087,50€
	LOT 2	12	4	32.125,00€
	LOT 3	38	6	116.900,00€
	Gjithësejt :	87	24	208.112,50€

**RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE
(RSEL)**

Projektet e realizuara nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I zhvillimit rajonal të balancuar”, (Viti 2018)

Në rajonin socio-ekonomik Lindje I cili përshin njëmbëdhjetë (11) Komuna: (Ferizaj, Gjilan, Han I Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpce, Viti, Klokot, Ranillug, Kamenicë dhe Partesh) në total janë mbështetur 29 projekte duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha Komunat përbërëse të këtij rajoni. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar- PZHRB (2018) në rajonin socio ekonomik Lindje janë pranuar nga AZHR Lindje 392 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga njëmbëdhjetë (11) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 392 , në kategorinë Lot 1 janë pranuar 154 aplikacione ,në kategorinë Lot 2 janë pranuar 64 aplikacione dhe në kategorinë Lot 3 janë pranuar 174 aplikacione.

Në kategorinë Lot 1 e cila kategori ka përfshirë financimin nga 1.000€ deri në vlerë 5000€ ndaj bizneseve të reja apo te ashtuquajtura “Start Up” është realizuar mbështetja financiare në vleren totale prej 72.009, 00€. Në rajonin socio-ekonomik Lindje janë financuar 16 projekte në total në kategorinë e LOT 1 dhe janë punësuar 37 persona .Veprimtaritë më të shpeshta kanë qenë: shërbimet e ndryshme si ato të tekstit, shtypit në 3D, veprimtaritë e prodhimit dhe të shërbimeve ku mund të veçohen: shërbimet e floktarisë dhe estetike, gjeodezike, industriale dhe të tekstit, rrobaqepësi stomatologji, shërbime të IT-së,dizajn, shërbime psiko sociale si dhe veprimtaritë prodhuese dhe të përpunimit të drurit, rrjetave të peshkimit, tekstit, uniformave,etj.Projektet e financuara kane plotësuar gjitha kriteret administrative dhe përmbajtësore të rregulluara sipas udhëzuesit përkatës së MZHR-së (2018).

Në kategorinë Lot 2 kanë gjet mbeshtetje financiare gjitha bizneset të cilet kanë pas përvojë deri në 2 vite në veprimtarinë e tyre biznese. Vlera totale e investuar nga Grant Skema e MZHR-së në kategorinë e LOT2 në Rajonin Lindje ka qenë 38.492, 00€, ku janë mbështet 6 biznese dhe janë punësuar 16 persona. Vlera e projekteve e financuar në Lot 2 ka variu deri në vleren 10.000€ ku gjitha projektet kanë plotësuar kriteret e percaktuara me udhëzusin për aplikim në Skemen e Granteve për zhvillim rajonal të balancuar. Llojet e veprimtarive më të shpeshta në Lot 2 kanë qenë veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese si: prodhimi I dyshekëve, paketimi I çjrave, frutave dhe melemsave, prodhimi I dyerve dhe dritareve, përpunimi dhe prodhimi I brumrave si dhe shërbimet elektrike dhe automekanike.

Bizneset të cilat kanë pasë për bazë veprimtaritë prodhuese me kapacitete më të mëdha të fuqisë punëtore dhe bizenset të cilat veprimtaria e tyre biznese ka qenë e regjistruar mbi dy vite kanë gjetë mbështetje financiare në kategorinë Lot 3 ku vlera totale e investuar në LOT 3 ka qenë 143.468, 00€ ku janë punësuar 48 persona brenda 8 projekteve . Vlera e projekteve të financuara në Lot 3 ka variu brenda vlerës deri 20.000€. Bizneset me veprimtaritë më të shquara në Lot 3 kanë qenë bizneset me veprimtari të prodhimit si energjisë së ripërtrishme,prodhimi dhe përpunimi I metaleve dhe produktev ushqimore, prodhimi I fellneve të automjeteve, investimet ne asete të

prekshme ,shërbimet e mirëmbajtjes së objekteve publike dhe private, shërbimet e printimit,etj.

Duke u bazuar në analizën e DPASER, veprimtaritë biznesore në rajonin socio ekonomik Lindje të mbështetura nga Grant Skema e lansuar nga MZHR për vitin 2018 kanë arrit mbështetje financiare në shumën totale prej 253.969, 00€ . Kjo mbështetje financiare nga MZHR ka arrit të punësoj 101 të papunuar. MZHR në rajonin socio ekonomik Lindje ka mbështet financiarisht 29 bizense në total.

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE					
(LOT 1)					
LOT 1	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Kamenicë	Parukeri dhe estetikë	2	1	2000
	Gjilan	Shërbime gjeodezike	1	1	5000
	Gjilan	Shërbime industrial të tekstit	2	1	4566
	Gjilan	Stomatologji	1	1	5000
	Ferizaj	Prodhim i uniformave	2	1	5000
	Shtërpce	Shërbime për IT	1	1	3600
	Viti	Stomatologji	1	1	4994.88
	Ferizaj	Mobileri (perpunimi i drurit per prodhim)	3	1	5000
	Gjilan	Sektori i gjeodezisë(keshillim shërbime)	2	1	5000
	Ferizaj	Sallon bukurie	2	1	4389
	Gjilan	Disajn /dekorim	4	1	3990
	Gjilan	Qendër psikosociale	6	1	5000
	Gjilan	Prodhim i rrjetave për peshkim	1	1	4800
	Ferizaj	Prodhimtari në tekstil	4	1	5000
	Gjilan	Rrobaqepësi	3	1	5000

Gjithësej (Lot 1)	37	15	72.009,00€
--------------------	----	----	------------

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE					
(LOT 2)					
LOT 2	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Gjilan	Prodhim i dyshekëve	2	1	8000
	Kaçanik	Makineri për paketimin dhe perpunimin e çajrave, frutave dhe melmesave	2	1	7038
	Gjilan	Sherbime automatike dhe elektrike	5	1	9954
	Gjilan	Garazh-Automekanik	3	1	5000
	Kamenicë	Prodhim i dyerve dhe dritareve	3	1	8500
	Ferizaj	Prodhim – përpunim i brumrave	1	1	5200
Gjithësej: (LOT 2)			16	6	38.492,00€

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE					
(LOT 3)					
LOT 3	Komuna përfituese	Përshkrimi i projektit	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	Viti	Prodhimi i energjisë së ripërtrishme	3	1	14.000,00
	Ferizaj	Investime në asete të prekshme	8	1	19.500,00
	Gjilan	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve të ndryshme	15	1	17,280,00
	Gjilan	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	5	1	15,988.00
	Gjilan	Shtyo-Grafik	5	1	19.200,00
	Gjilan	Përpunimi i produkteve (kerpurdhave,	3	1	20.000,00

		frutave dhe perimeve)			
	Ferizaj	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	6	1	17.500,00
	Ferizaj	Përpunimi dhe riparimi i felleve për automjete	3	1	20.000,00
Gjithësej (Lot 3)			48	8	143.468,00€

Tabela e përgjithëshme e investimeve për rajonin socio-ekonomik Lindje (Lot1, Lot2, Lot3):


RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE	Lot1, Lot2, Lot3	Numri i të punsuarve	Numri i bizneseve përfituese	Vlera e financuar nga MZHR (€)
	LOT 1	37	15	72.009,00€
	LOT 2	16	6	38.492,00€
	LOT 3	48	8	143.468,00€
	Gjithësej :	101	29	253.969,00€

PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE

Mëposht janë të paraqitura në formë të Grafikonit në përqindje vlerat tabelare të interpretuara edhe në narracion për pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore në Kosovë (Rajonin Qendër, Rajonin Veri, Rajonin Jug, Rajonin Lindje dhe Rajonin Perëndim). Gjithashtu vlerat janë të ndara në Lote (1, 2, 3) për secilin rajon në veçanti me qëllim të një pasqyrimi më të qartë dhe transparent të pesë (5) rajoneve zhvillimore.


Rajoni Socio – Ekonomik Qendër

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas Loteve në Rajonin Socio- Ekonomik Qendër nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I zhvillimit rajonal të balancuar” viti 2018, në %, paraqitet si në Grafikonin në vijim:




Rajoni Socio – Ekonomik Jug

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas Loteve në Rajonin Socio Ekonomik Jug nga MZHR në kuadër të Skemës së Granteve “Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar” viti 2018, në %, paraqitet si në Grafikonin në vijim:




Rajoni Socio – Ekonomik Perëndim

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas Loteve në Rajonin Socio-Ekonomik Perëndim nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar” 2018, në %, paraqitet si në Grafikonin në vijim:




Rajoni Socio – Ekonomik Veri

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas Loteve në Rajonin Veri nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar” viti 2018, në % paraqitet si në Grafikonin në vijim:



Rajoni Socio – Ekonomik Lindje

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas Loteve në Rajonin Socio-Ekonomik Lindje nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve “Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar” viti 2018, në % paraqitet si në Grafikonin në vijim:




Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) duke përfshi 3 Lotet (Lot1, Lot2 dhe Lot3) në pesë (5) Rajonet Socio – Ekonomike Zhvillimore në Kosovë

Në grafikonin e mëposhtëm vërejmë një shpërndarje mjaftueshëm të balancuar me diferenca apo disbalance të vogla 2% deri 8% në rajone të caktuara në përgjithësi. Nga grafikonin e mëposhtëm mund të shohim se Rajoni Veri ka përqindjen më të vogël prej 15% në krahasim me rajonet tjera. Një përqindje e tillë ka rezultuar përshkak të numrit më të vogël të aplikimeve të pranuar nga Rajoni Veri e cila situatë ka çuar në një konkurrueshmëri më të vogël në raport me rajonet tjera socio-ekonomike zhvillimore në Kosovë. Subvencionimi i bizneseve në pesë (5) rajonet socio ekonomike të Kosovës është bërë konform Udhëzuesit administrativ për përmbushjen e kriteve për secilin Lot në veçanti.

PESË (5) RAJONET SOCIO-EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT-PZHRB 2018 (€)
Rajoni socio Ekonomik Qendër	277.211,00
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	304.349,20
Rajoni socio- Ekonomik Perëndim	303,163.50
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	208.112,50
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	253.969.00
GJITHËSEJT:	1.346.806.00€


Pesë (5) Rajonet Socio-Ekonomike Zhvillimore




Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) duke përfshi 3 Lotet (Lot1, Lot2 dhe Lot3) në pesë (5) Rajonet Socio – Ekonomike Zhvillimore në Kosovë në bazë të përkatësisë etnike.

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar", për Vitin 2018 ka mbështetur financiarisht një numër relativisht të madh të projekteve të komuniteteve tjera në Kosove (Serb, Boshnjak, Turq, RAE dhe Goran) ,në një përqindje mjaftueshëm të lartë prej 17% ne raport me numrin e përgjithëshëm të komuniteteve në Kosovë.

Shpërndarja në bazë të përkatësisë etnike




Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar”, për Vitin 2018 ka mbështetur financiarisht pesëdhjetë e dy biznese (52) të udhëhequra nga gratë.



Shpërndarja e pesëdhjetë e dy (52) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë

PEŠË (5) RAJONET SOCIO-EKONOMIKE	NUMRI I PËRGJITHËSHËM I PROJEKTEVE
Rajoni socio Ekonomik Qendër	11
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	6
Rajoni socio- Ekonomik Perëndim	12
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	13
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	10
GJITHËSEJT:	52



BURIMET E INFORMACIONIT :

- Raporti i Komsionit të Vlerësimit (PZHRB) 2018, protokoluar me datë: 06/04/2018 dhe Nr.protokoli: 102/1
- Bazuar në Raportin financiar vjetor të protokolluar me datë ; 31.01.2019, dhe nr. Protokoli 45
- Udhëzuesi administrativ nr:01/2018 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim rajonal të balancuar PZHR 2018.
- https://www.balkanplus.net/wp-content/uploads/2019/03/Raporti-vjetor-i-Subvencioneve-PZHRB-2018-1_compressed-2_reduce.pdf

PËRFUNDIME

Edhe pse viti 2018 ishte viti i parë i implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të balancuar (2018), MZHR ka arrit të përmbush synimet dhe planifikimet e saj për avancim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar.

Përmes PZHRB (2018), është stimuluar një numër i mirë i bizneseve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij programi, është aplikuar një qasje konstruktive dhe profesionale ndaj aplikantëve, si psh: realizimit të sesioneve informuese në secilin rajon, për sqarimin e Programit dhe procedurave të aplikimit, ofrimit të përgjigjeve përmes ueb faqes në pyetjet e parashtruara nga aplikantët gjatë procesit të aplikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit me AZHR-të për pranimin e aplikimeve nga aplikantët, si dhe publikimit të në ueb faqe të Udhëzuesve ku kanë qenë të specifikuara në detaje të gjitha kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2018.

Implementimi i këtij Programi në shumë prej 1.4 milion euro, përmes përkrahjes së bizneseve të reja me potencial ritje, punësimit të 561 përsoneve, si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksportit të produkteve vendore, ka ndikuar pozitivisht edhe në mirëqenjen e përgjithëshme të qytetarëve. Është inkurajues fakti se nga 145 projekte, 52 projekte udhëhiqen nga gjinia femërore. Në rajonin në të cilin më së shumti kanë përfituar gratë, është Rajoni Veri (Mitrovica Jugore me komunat për rreth). Ajo qka duhet ti kushtohet më tepër rëndësi, është stimulimi i aplikimit nga komunitetet jo shumicë. 17% e përfituesve nga komunitetet tjera, është një shifër jo e ulët por që mund të promovohet për ngritje edhe më të madhe. Rritja e buxhetit nga viti 2018 sa ishte 1.4 në 2.5 në vitin 2019, është një argument shtesë për ritje edhe të numrit të përfituesve. Përveç identifikimit të përparësive dhe efekteve pozitive, përmes kësaj analize theksojmë edhe mangësitë dhe vështirsitë që janë procesit të realizimit të Proragmit. Procesi i aplikimit në Skemën e Granteve PZHRB (2018) është realizuar përmes sistemit klasik të aplikimit fizik në letër dhe kjo formë e aplikimit dhe kompletimit të dokumentacionit ka paraqit vështirsi edhe për aplikantët edhe për MZHR-në gjatë procesit të vlerësimit.

Bazuar në këtë MZHR ka avancuar teknikisht për vitin 2019 sistemin e aplikimit, duke e transferuar nga një sistem klasik në letër, në një sistem elektronik online të aplikimit – SMAED. Ky sistem, ju ka lehtësuar aplikantëve aplikimit duke e realizuar këtë aktivitet edhe nga shtëpia, përmes plotësimit të gjithë dosjes në formular të caktuar. Me funksionalizimin e Sistemit SMAED, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka synuar të arrijë: ekonomizimin dhe efektshmërinë në kohës gjatë procesit të aplikimit, avancimim e nivelit të aplikimit, të rrit transparencën dhe llogaridhënjen në raport me aplikantët dhe përshpejtimin e procesit të vlerësimit. Gjatë procesit të vlerësimit shpesh është vërejtur që projektet e Start –Up –ve kanë qenë projekte të varfëra tekstualisht në përshkrimin e objektivave dhe kriterëve që kanë qenë të parapara në Udhëzues, gjë që obligon MZHR-në të zhvilloj politika dhe programe për avansimin e kapaciteteve humane për të pranuar sa më shumë projekte profesionale dhe të implementueshme. Në këtë kontekst, MZHR duhet të rrisë përkushtimin e krijimit të mundësive edhe me donatorë vendor dhe ndërkombëtar, në kontekst të ngritjes së kapaciteteve të interesuarve për aplikim dhe implementim të projektve në vitit në vijim.